



Shërbime ku mund të drejtohesh

**Sekretaria e Përgjithshme e Barazisë
Qendra Këshillimore për Dhunën ndaj Grave**

- Athinë: Tel.: 210 3317305- 6
- Pire: Tel.: 210 4112091, 4129101

**Qendra Kombëtare
e Solidaritetit Social (EKKA)**
Linja SOS : 197

**Organizata Ndërkombëtare
e Emigracionit (D.O.M.)**
Tel.: 210 9919040 - 5

**Drejtoria e Rendit Publik - Attikë
Sekcioni i moralit:** Tel.: 210 6476238

**Drejtoria e Rendit Publik - Selanik
Sekcioni i moralit:** Tel.: 2310 388366

Organizata Joqeveritare

**Qendra Kërkimore e Mbështetjes së Viktimave
të Keqtrajtimit dhe Izolimit Social
Janinë, Linja SOS: 26510 33033**

**Qendra e Rehabilitimit të Viktimave të
Torturës dhe Formave të Tjera të Keqtrajtimit
Selanik, Tel.: 2310 555378**

Rrjeti i Grave të Europës
Linja SOS: 800 11 88881

Klimaka
Tel.: 210 3417160 -163

**Shoqëria Ndërkombëtare e Mbështetjes
së Familjes (DESO)**
Tel.: 210 8104079

Alilengjii (OJQ e Kishës së Greqisë)
Linja telefonike SOS: 800 1137777,
210 8695038 - 40

**Lidhja e Shoqatave të Grave
të Iraklions - Kretë**
Linja SOS: 800 1116000



**SEKRETARIA
E PËRGJITHSHME
E BARAZISË**

Dragatsaniou 8, 10559 Athinë

Tel.: 210-3315291-5

Fax: 210-3315276

e-mail: info@isotita.gr | www.isotita.gr

MINISTRIA E BRENDSHME
ADMINISTRATËS PUBLIKE
& DECENTRALIZIMIT



SEKRETARIA
E PËRGJITHSHME
E BARAZISË



Çështë trafikimi i qenieve njerëzore

Trafikimi i qenieve njerëzore për qëllime prostitucioni, është një fenomen me përmasa ndërkontaktuale që ka prekur varet e fundit edhe vendin tonë.

Viktimat janë kryesisht gra që, në kushtet e varfërisë dhe të papunësisë, përpiken të emigrojnë në kërkim të një pune në një vend tjetër, për të përballuar mbi jetesën e tyre dhe të familjes.

Trafikantët e rrjeteve të ndryshme ilegale i afrojnë dhe i mashtrojnë në këmbim të premtiveve për punësim të menjëherëshmë dhe një jetë më të mirë, por, i shtyjnë në fakt drejt prostitucionit të detyruar nëpërmjet kërcenimeve për jetën e tyre apo të të afërmëve të tyre, nëpërmjet përdhunimeve, keqtrajtimeve, bile edhe vrasjeve.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një sklavëri e kohëve moderne, është forma më e ulët e keqtrajtimit që ushtrohet mbi gratë. Poshtëron dinjitetin njerëzor dhe dhunon të drejtat e njeriut.

Roli i klientit

Klienti që përfiton nga "shërbimet" e këtyre grave është bashkëfajtor i ekzistencës së fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime prostitucioni. Duhet të dijë se rruga që ndjekin nuk është zgjedhje, por detyrim në kushtet e sistemit të skllavërisë. Duhet të dijë se me pjesëmarjen e tij mbështet fuqimisht rrjetin e trafikantëve të qenieve njerëzore.

QË TË MOS BIESH VIKTIMË, DUHET TË DISH

Nëse mendon të emigrosh në Greqi për të punuar:

- Kërko informacion zyrtar nga shërbimet që funksionojnë në vendin tënd, para se të përgatitesh për udhëtim.
- Komunikoni dhe merr informacion nga organizatat e mbrojtjes së të drejtave të grave në vendin tënd.
- Përpiku të mësosh gjuhën e vendit që zgjedh për të punuar, për të shmangur situata të vështira nga mosnjohja e gjuhës.
- Mos u beso personave që të premojnë lehtë gjetje pune dhe shpërblime të majme.
- Ji e rezervuar dhe mos ua jep lehtë dokumentat e tua të udhëtimit, p.sh pasaportën tënde, personave që s'i njeh mirë.
- Informo rrithin tend familjar për destinacionin e saktë të udhëtimit.

Kur të vish të Greqi:

- Kujdesu për legalizimin tënd, për të mos krijuar probleme me autoritetet.
- Nëse dyshon se dikush apo disa përpiken të përfitojnë nga puna jote ose të detyrojnë të veprosh pa vullnetin tënd, dije se ka shërbime ku mund të drejtohesh për ndihmë dhe të kërkosh të drejtat e tua. Ta dish se ka një Ligj që të mbron dhe ka shërbime që kanë mundësi të të mbështesin.

C' parashikon legjislacioni ?

Trafikimi i qenieve njerëzore është krim dhe dënohet rreptësisht. Dënohet si trafikanti ashtu edhe klienti, kur ka dijeni se viktima është e mitur.

Gjithashtu

Viktimës që u drejtohet organeve të ndjekjes penale dhe denoncon aktet e kundraligjshme i garanton:

- Afat njëmuajor për ta menduar bashkëpunimin me autoritetet kompetente.
- Pezullimi i ekstradimit të mundshëm
- Leje qëndrimi dhe leje pune njëvjeçare
- Strehim, siguri, marrje nën mbrotje, trajtim mjekësor
- Mbështetje juridike falas, interpretim dhe përkthim në gjuhën amtare
- Akses në shkollat publike dhe në programe të ndryshme të trajnimit dhe aftësimit profesional të organizmave përkatëse.
- Riatdhesim i garantuar nëse dëshiron dhe rigjetje e familjes kur është në moshë të mitur.

Së fundi, në kushte të caktuara, garantohet integrimi i ligjshëm dhe i natyrshëm social dhe profesional në jetën e vendit tonë.